

Shënime Teknike: COVID-19 dhe Fëmijët e Privuar nga Liria



Foto nga: © UNICEF/UNI117442/Estey

Hyrje

Përvoja nga shpërthime të mëparshme të sëmundjeve infektive ka treguar se rreziqe të reja ndaj mbrojtjes së fëmijës ka të ngjarë të shfaqen si pasojë e drejtpërdrejtë e COVID-19 dhe e masave të marra për të parandaluar dhe mbajtur nën kontroll përhapjen e tij. Po ashtu, ka të ngjarë që edhe rreziqet ekzistuese ndaj mbrojtjes së fëmijës të bëhen më të mprehta. Disa grupe individësh janë edhe më të cenuar në këto rrethana, duke përfshirë, ashtu sic shtjellohet në këto shënime, edhe fëmijët e privuar nga liria, të cilët shpesh kanë probleme psiko-sociale, fizike si dhe të shëndetit mendor, jetojnë në kushte johigjienike dhe cenohen më lehtë nga abuzimi dhe lënia pas dore.

Mësimet e nxjerra nga epidemitë në të kaluarën e vënë theksin te nevoja që Shtetet t'i marrin parasysh nevojat e shtuara për mbrojtjen e fëmijëve, në procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve të tyre në përgjigje ndaj epidemisë. Nëse këto nuk adresohen si duhet ose në rast se vonohet zbatimi i një përgjigjeje të koordinuar, vuajtja e fëmijëve mund të shtohet, atyre mund t'u shkaktohet dëm i pakthyesëm dhe komunitete të tëra mund ta marrin veten me vonesë.

Në përgjigjen ndaj pandemisë së COVID-19, Shtetet duhet të sigurohen që të drejtat e çdo fëmije të privuar nga liria të respektohen, mbrohen dhe përmbushen plotësisht. Kjo përfshin edhe ofrimin e kujdesit të duhur, mbrojtjen nga dëmtimi, marrjen e masave për uljen e mbipopullimit në të gjitha mjediset ku ata mund të mbahen të mbyllur, për kthimin e tyre në siguri të plotë pranë familjeve, apo pranë kujdesit komunitar apo të natyrës jo izoluese. Kjo do të thotë, po ashtu, se të gjitha vendimet dhe veprimet që lidhen me fëmijët duhet të udhëhiqen nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, nga e drejta e fëmijës për jetën, mbijetesën dhe zhvillimin, si dhe e drejta e tij/saj për t'u dëgjuar.

Këto shënime synojnë t'u ofrojnë autoriteteve të privimit të lirisë disa informacione thelbësore dhe t'u propozojnë disa hapa për t'iu përgjigjur COVID-19-ës, përfshi këtu edhe:

1. Vendosjen e një moratoriumi për hyrjet e reja të të miturve në mjedise të privimit të lirisë;
2. Lirimin e të gjithë atyre të miturve që mund të lirohen në siguri të plotë; dhe
3. Mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së gjithë atyre të miturve që iu duhet të mbeten në burgim.

1. Të kuptojmë si t'i mbrojmë të drejtat e fëmijëve të privuar nga liria dhe të mënjanojmë rritjen e burgimit të fëmijëve gjatë kësaj periudhe e përtej saj

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) gjen zbatim për të gjithë fëmijët, në çfarëdo konteksti, përfshi edhe në situata të urgjencës. [Qindra e mijëra fëmijë](#), në çfarëdo dite të vitit, janë të vendosur në mjedise burgimi a paraburgimi, të privuar nga liria. Teksa kushdo mund të infektohet nga sëmundja e koronavirusit (COVID-19), fëmijët e privuar nga liria në institucione të mbyllura, përfshi edhe ata fëmijë që ndodhen brenda në burg bashkë me prindin apo kujdestarin e vet, ata që ndodhen të mbyllur në institucionet për imigrantëtⁱ dhe ata që janë të mbyllur për motive të sigurisë kombëtare,ⁱⁱⁱ përballen me një rrezik të shtuar për t'u infektuar apo për ta përhapur këtë sëmundje.^{iv} Masat e vendosura për të mbajtur nën kontroll përhapjen e virusit dhe pasojat shoqërore që ato sjellin, po ashtu kanë të ngjarë të ndikojnë negativisht në mirëqenien si dhe në zhvillimin e tyre të shëndetshëm, duke përfshirë këtu edhe kujdesin e duhur gjatë burgimit/paraburgimit apo mbështetjen e familjare dhe komunitare.

Në bazë të nenit 24 të KDF-së, fëmijët kanë të drejtën e standardit më të lartë të mundshëm të shëndetit. Fëmijët e privuar nga liria janë më të rrezikuar të infektohen me COVID-19 pikërisht për shkak të kushteve të mbyllura në të cilat jetojnë. Privimi i lirisë e bën më të vështirë vetizolimën apo praktikën e distancimit shoqëror, veçanërisht në institucione që janë të mbipopulluara dhe të papastra, ku personeli i sigurisë apo kushtet infrastrukturore krijojnë kufizime për përdorimin e ujit, mjeteve dezinfektuese dhe higjienës bazë. Fëmijët e privuar nga liria kanë disa karakteristika të përbashkëta demografike dhe përgjithësisht nuk gëzojnë shëndet aq të mirë sa pjesa tjetër e popullatës, gjë që bën që ata të kenë ose të preken nga probleme shëndetësore, fizike dhe psiko-sociale. Këto me gjasa bëhen edhe më të mprehta nga vendosja e tyre në burgim a paraburgim, ku përballen edhe me mungesën e shërbimeve shëndetësore cilësore, edhe përpara se të dilte kjo emergjencë. Shpesh këta fëmijë nuk kanë

ushqim të mirë dhe u mungojnë shërbimet me cilësi, përfshi këtu mbështetjen psiko-sociale ose atë të shëndetit mendor, shërbimet shoqërore apo arsimore. Në këto kushte, institucionet e privimit të lirisë mund të kthehen në burim infeksioni, shtimi dhe përhapjeje të COVID-19, si brenda, ashtu edhe jashtë këtyre mjediseve.

Mjediset e privimit nga liria, jo vetëm i vënë fëmijët para rrezikut serioz për t'u infektuar nga virusi, por vënë në rrezik edhe personelin që punon nëpër këto institucione (oficerët e policisë apo të burgut, kujdestarët, punonjësit socialë, personelin shëndetësor, etj.), si dhe familjet dhe komunitetin e tyre. Mund të ndodhë që personeli të mos jetë i pajisur me mjetet e duhura mbrojtëse. Në shumë vende COVID-19 ka [nisur të godasë burgjet](#), dhomat e izolimit nëpër polici si dhe qendrat e imigracionit, e po ashtu edhe vende të tjera ku fëmijët mund të jenë të privuar nga liria.^v Kjo ka bërë që shumë vende të ndërmarrin tanimë hapa që t'i dalin para këtij rreziku, duke ulur numrin e fëmijëve të privuar nga liria.^{vi}

Veç kësaj, vetë masat e marra brenda institucionit të privimit të lirisë për parandalimin e rrezikut për shëndetin publik apo për mbajtjen nën kontroll të sëmundjes, mund ta vendosin fëmijën përpara rrezikut të shtuar ndaj dhunës, përfshi edhe dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu, në shumë raste, institucionet e privimit të lirisë ndodhen larg nga familjet, shtëpitë dhe komuniteti i këtyre fëmijëve, duke bërë që komunikimi i rregullt me ta të jetë i kufizuar. Kjo çon në rritjen e nivelit të frikës dhe pasigurisë, të cilat nga ana e tyre ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre (përfshi këtu edhe [mirëqenien mendore dhe psiko-sociale](#)). Fëmijët mund të përballen edhe me damkosjen, atëherë kur infeksioni shpërthen brenda mjediseve të privimit të lirisë, duke i lënë ata akoma edhe më mbrapa të tjerëve. Po ashtu, nëse personeli sëmuret, kjo mund të çojë në uljen e numrit të punonjësve që mund të ofrojnë kujdes dhe mbrojtje ndaj fëmijëve, përtej pragut të pranueshëm, duke bërë kështu që ata të përballen me mungesë kujdesi dhe mbikqyrjeje, rrezik të shtuar të dhunës, abuzimit apo lënies pas dore, apo me gjasa, izolimit të tyre në hapësira më të vogla, ku mund të kontrollohen dhe mbahen më lehtë nën vëzhgim.^{vii}

Në disa vende, masat për ndalimin e përhapjes së COVID-19, realisht po rritin numrin e fëmijëve të privuar nga liria, ose të atyre që nuk mund të lirohen, edhe pse bëhet amnisti apo lëshohet urdhër për lirim të tyre, me qëllim shpopullimin e burgjeve dhe mjediseve të paraburgimit. Si masa të tilla mund të përmendim: mbylljen e gjykatave, pezullimin e gjykimeve penale apo dëgjësive administrative, kufizimin e lirisë së lëvizjes, qasjen e kufizuar ndaj shërbimit të avokatëve, mungesën e takimit të fëmijëve të privuar nga liria me familjarët e tyre, mbylljen e kufijve dhe shtimin e masave me burgim para riatdhesimeve dhe kthimeve me forcë, në vend që këto t'i pezullojnë dhe t'i lirojnë fëmijët pranë programeve joizoluese dhe alternative.

2. Rekomandime lidhur me përdorimin e masave të privimit të lirisë dhe atyre urgjente gjatë shpërthimit të COVID-19

2.1 Konsiderata Thelbësore për Zbatimin e Masave të Urgjencës

Masat që Shtetet mund të marrin për të luftuar pandeminë e COVID-19 lidhur me fëmijët e privuar nga liria, [përfshi këtu edhe masat urgjente që merren për motive të shëndetit publik](#), duhet të jenë plotësisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe standardet e të drejtave të njeriut. Çfarëdo mase duhet të jetë proporcionale, e nevojshme, e kufizuar në kohë, t'i

nënshtrohet rishikimit të herëpashershëm, të jetë jo diskriminuese përballë rrezikut të vlerësuar, si dhe të jetë në interesin më të lartë të të miturit.

- Shtetet nuk duhet t'i përdorin masat urgjente në një mënyrë të atillë që [shkel të drejtat e fëmijës](#), duke përfshirë këtu privimin e fëmijës nga liria, duke patur parasysh se disa të drejta janë të paprekshme^{viii}.
- Shtetet duhet të bëjnë kujdes të posaçëm për adresimin e atyre problemeve specifike që prekin [vajzat](#) dhe [djemtë](#), fëmijët që mund të diskriminohen për shkak [të orientimit seksual apo identitetit gjinor](#), [fëmijët me aftësi të kufizuara](#), fëmijët migrantë/të zhvendosur/pa shtetësi, fëmijët indigjenë, ata nga komunitetet e pakicave etnike, fëmijët në situatë rruge dhe nga grupe të tjera të cenueshme apo të mënjanuara.
- Shtetet duhet të sigurohen që masat urgjente që merren për të parandaluar, mbajtur nën kontroll apo për t'iu përgjigjur virusit, të mos rezultojnë në mbajtjen në burg të atyre fëmijëve që i kishin përmbushur kushtet për t'u liruar apo në rritjen e numrit të fëmijëve të privuar nga liria.

2.2 Respektimi i të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe i Standardeve të Drejtësisë për të Mitur

Shtetet vijojnë të kenë detyrimin ligjor për të respektuar të drejtën ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut si dhe standardet^{ix} e drejtësisë për të mitur, përfshi edhe:

- Si rregull, ta përdorin arrestimin, paraburgimin dhe burgimin vetëm si masën më të fundit dhe për kohën më të shkurtër të mundshme;
- T'i japin fund pa vonesë dhe tërësisht privimit të lirisë së fëmijëve, për shkak të statusit të prindërve të tyre si migrantë, pasi kjo nuk është asnjëherë në interesin më të lartë të të miturit dhe ta ndalojë burgimin e fëmijëve për shkaqe imigracioni, si në ligj, ashtu edhe nëpër politika dhe në praktikë;
- Ta trajtojnë çdo të mitur të privuar nga liria me njerëzi dhe me respektin për dinjitetin që bart çdo qenie njerëzore, si dhe të përmbushë plotësisht të drejtat e tyre për një proces të rregullt ligjor si dhe garancitë e tyre procedurale; Organet publike, përfshi prokurorët dhe gjyqtarët duhet t'i ushtrojnë kompetencat e tyre lidhur me privimin e lirisë së të miturve me shumë maturi, duke patur në konsideratë natyrën ekstreme të këtyre masave, cenueshmërinë e lartë që karakterizon fëmijën dhe respektimin e interesit më të lartë të fëmijës si konsideratë parësore, veçanërisht në kontekstin e COVID-19. Masat alternative duhet të nxiten dhe të përdoren para të gjitha të tjerave, me të gjitha garancitë e duhura për fëmijët dhe familjet në këtë situatë;
- Të vënë në zbatim masa të tilla që çdo fëmijë të arrijë të ruajë kontakte të rregulla me familjen e tij apo të saj, përmes korrespondencës dhe vizitave;
- T'i sigurojnë çdo të mituri/e të privuar nga liria qasje të menjëhershme në ndihmën e specializuar ligjore apo në lloje të tjera ndihme të përshtatshme, si dhe mënyrën dhe mjetet për ta kundërshtuar ligjshmërinë e masës me privim lirie përpara gjykatës apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, e po kështu t'i garantojnë një vendimmarrje pa vonesë lidhur me këtë proces;

- Atëherë kur të miturit nuk mund të lirohen ose marrja e masave alternative është e pamundur, të ndërmarrin hapa konkrete për përmirësimin dhe ruajtjen e kushteve të tilla në mjediset e privimit të lirisë, të cilat përmbushin standardet minimale ndërkombëtare përkatëse,^x përfshi respektimin e raportit të numrit të personelit/fëmijë, si dhe t'u ofrojnë të miturve të gjitha shërbimet e nevojshme.

2.3 Mbrojtja nga Diskriminimi

Shtetet duhet të vënë në zbatim garancitë kundër diskriminimit:

- Shtetet duhet t'u ofrojnë fëmijëve të privuar nga liria qasjen në të njëjtat nivele të shërbimit shëndetësor apo të shërbimeve të tjera që ofrohen për fëmijët në komunitet, pa asnjë diskriminim;
- Shtetet duhet të ndërmarrin masat e duhura për të siguruar një qasje që iu përgjigjet nevojave gjinore lidhur me përgjigjen ndaj situatës së COVID-19, në ato mjedise ku fëmijët janë të privuar nga liria, duke përfshirë edhe plotësimin e nevojave të posaçme të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, të cilët janë në kushtet e privimit të lirisë bashkë me nënat e tyre, e sidomos kur këto nëna i kanë fëmijët në gji;
- Shtetet duhet t'u ofrojnë të miturve të privuar nga liria, të njëjtin informacion që iu jepet edhe fëmijëve të tjerë në komunitet, lidhur me pandeminë dhe se si të mbrohen, duke bërë të mundur që ky informacion të jetë i arritshëm dhe njëkohësisht i kuptueshëm për të miturit;^{xi}
- Shtetet duhet të mënjanojnë mbylljen e fëmijëve që jetojnë në rrugë, duke patur parasysh se situata e tyre e veçantë mund ta bëjë të pamundur respektimin e disa masave për ndalimin e përhapjes së COVID-19. Në këto raste fëmijët duhet të referohen te autoritetet kombëtare të mbrojtjes së fëmijës ose në shërbime joqeveritare.

3. Rekomandime për të siguruar lirinë e menjëhershëm, përdorimin e masave alternative ose mosfutjen e fëmijëve të tjerë në mjedise të privimit të lirisë gjatë kohës që vazhdon pandemia e COVID-19

Në respekt të standardeve të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut, përta i përket [drejtësisë për të mitur](#) dhe fëmijëve të privuar nga liria, në bazë të [Udhëzuesit të Ndërmjetëm të OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë](#) (Udhëzuesi i OBSH-së për COVID-19 në burgje) si dhe [Udhëzuesit të Ndërmjetëm të Komitetit të Përhershëm Ndër Agjenci lidhur me COVID-19: Me në Qendër Personat e Privuar nga Liria](#) (Udhëzuesi i Ndërmjetëm i KPNA-së), [Standardet Minimum për Mbrojtjen e Fëmijëve në Veprimtarinë Humanitare](#),^{xii} *Shtetet duhet t'i japin prioritet shmangies së fëmijëve nga proceset ligjore formale dhe të përdorin alternativa ndaj burgimit në të gjitha fazat e proceseve penale apo administrative.* Për këtë qëllim:

3.1 Prioritizimi i të Miturve për Lirim të Menjëhershëm

Shtetet duhet të lirojnë menjëherë ata fëmijë që mund të kthehen në mënyrë të sigurt pranë familjeve dhe komuniteteve të tyre. Atëherë kur është e mundur që kjo të bëhet në mënyrë të

sigurt, me konsideratën e duhur ndaj interesit më të lartë të të miturit, përfshi edhe rrezikun e shtuar që ka një fëmijë i privuar nga liria për t'u prekur nga sëmundja, Shtetet duhet të prioritzojnë lirinë e fëmijëve të privuar nga liria që të kthehen pranë familjeve të tyre, të afërme, pranë kujdesit të ngjashëm me familjen, në komunitet apo pranë institucioneve të përshtatshme të kujdesit shëndetësor:

- Të gjithë fëmijët dhe personat që kujdesen për ta, të cilët janë të privuar nga liria së bashku, për shkak të proceseve penale ndaj kujdestarit, për vepra të lehta dhe jo të dhunshme, ose kur personi është në prag të lirit apo në përfundim të dënimit të vet;^{xiii}
- Të gjithë fëmijët në paraburgim, pavarësisht veprës së kryer, duke qenë se ata prezumohen të pafajshëm;
- Të gjithë fëmijët e privuar nga liria për vepra specifike të ndaluara për të mitur (vepra të cilat nuk konsiderohen penale nëse kryhen nga të rriturit);
- Të gjithë fëmijët që kanë rrezik të lartë për të patur komplikacione në rast infektimi, përfshi ata fëmijë që kanë probleme të shëndetit fizik apo mendor, edhe pa qenë të infektuar nga COVID-19;
- Të gjithë fëmijët e dënuar për vepra të lehta dhe jo të dhunshme, si dhe ata që janë në prag lirim apo drejt fundit të dënimeve të tyre;
- Të gjithë fëmijët e privuar nga liria për shkak imigracioni;^{xiv}
- Të gjithë fëmijët e privuar nga liria për shkak të çështjeve të sigurisë kombëtare ose të lidhur me grupe të armatosura;^{xv}
- Çdo fëmijë tjetër, për të cilin konsiderohet se lrimi është i mundshëm ose mund të bëhet në mënyrë të sigurt.

Duhet marrë në konsideratë edhe mundësia për të bërë një lirim masivisht, bazuar mbi kriteret e mësipërme dhe nën dritën e urgjencës së situatës aktuale. Shtetet duhet të ofrojnë mbështetje dhe të punojnë me familjet për të bërë të mundur riintegrimin në mënyrë të sigurt të fëmijëve^{xvi} pranë familjeve dhe komuniteteve, në përputhje me interesin më të lartë të tyre, duke përdorur proceset e menaxhimit të rastit – përfshi: autorizimet e nevojshme për të udhëtuar, referimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre pranë kujdesit shëndetësor (p.sh. për COVID-19), të shërbimit të shëndetit mendor dhe ato psiko-sociale (p.sh. kujdes klinik), të shërbimit për prandalimin dhe reagimin ndaj dhunës (përfshi dhunën me bazë gjinore), të shërbimit arsimor dhe në të tjera mundësi.

Hapat që mund të ndërmerren **organet kyçe të drejtësisë për të parandaluar privimin e lirisë ose lirinë e fëmijëve nga burgimi/paraburgimi** gjatë pandemisë së COVID-19.

Policia, institucionet e korrektimit, Imigracioni, policia kufitare si dhe punonjës të tjerë të zbatimit të ligjit munden që:

- ✓ Të mënjanojnë gjokat, të reduktojnë dërgimet për ndjekje penale, arrestimet dhe privimin e të miturve nga liria, përfshi këtu edhe masa të ngjashme të ndërmarra për shkak të mospërhapjes së epidemisë, si për shembull për shkak të shkeljes së afateve apo kushteve të kufizimit të lëvizjes
- ✓ Të përdorin teknika miqësore për fëmijët dhe të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, sa herë ndërveprojnë me të miturit
- ✓ T'i shmangin fëmijët nga sistemi formal i drejtësisë sa më herët që të jetë e mundur, menjëherë pas kontaktit të parë dhe në faza të ndryshme gjatë procesit ligjor
- ✓ T'i rishikojnë kërkesat e shërbimit të provës apo të mbikqyrjes për të miturit (sidomos takimet fizike), për të mundësuar distancimin fizik, kurdoherë që të jetë e mundur (p.sh: duke përdorur teknologjinë për takime apo mbikqyrje)
- ✓ Në proceset e imigracionit, të identifikojnë të gjithë fëmijët migrantë dhe familjet e tyre dhe t'i referojnë menjëherë pranë punonjësve të mbrojtjes së fëmijës dhe atyre që ofrojnë kujdes

Prokurorët, avokatët mbrojtës, ofruesit e ndihmës ligjore mund të ngrenë zërin dhe të kërkojnë:

- ✓ Lirinë e menjëhershme dhe para kohe të të gjithë fëmijëve nga mjediset e privimit të lirisë (në bazë të këtyre rekomandimeve)
- ✓ Shmangien e të miturit nga sistemi formal i drejtësisë sa më herët që të jetë e mundur, menjëherë pas kontaktit të parë dhe në faza të ndryshme gjatë procesit ligjor
- ✓ Përdorimin me përparësi të masave që nuk e privojnë të miturin nga liria, duke përfshirë edhe masa alternative ndaj burgimit apo programe të shmangies (si të jetë e përshtatshme sipas rastit)
- ✓ Nxjerrjen e faljeve masive, amnistive dhe urdhërave për lirinë masivisht të të miturve

Gjykatat munden:

- ✓ Të reduktojnë seancat publike apo ku kërkohet paraqitja e personit, duke vënë në përdorim modalitete alternative, por që nuk e cenojnë të drejtën themelore të të miturit për një gjykim të drejtë e të ndershëm
- ✓ Të marrin në konsideratë pasojat shëndetësore të çfarëdo vendimi që ka të bëjë me privimin e lirisë së të miturve
- ✓ Të kufizojnë dhe minimizojnë përdorimin e të gjitha vendimeve me heqje lirie për fëmijët (si para, ashtu edhe pas përfundimit të gjyqimit)
- ✓ T'i shmangin fëmijët nga sistemi i drejtësisë
- ✓ Të rritin përdorimin e masave që nuk e privojnë fëmijën nga liria, përfshi alternativa të dënimit me burgim dhe programe shmangieje (si të jetë e përshtatshme sipas rastit)
- ✓ Të nxjerrin falje masive, amnisti dhe urdhëra për lirinë masivisht të të miturve

Ligjvënësit dhe politikëbërësit munden:

Të miratojnë ligje, politika dhe rregullore që ulin mbipopullimin në institucionet për të miturit dhe numrin e të miturve të privuar nga liria, duke përfshirë:

- ✓ Heqjen menjëherë nga legjislati të veprave të dënueshme vetëm për të miturit
- ✓ Nxjerrjen e faljeve masive, amnistive dhe urdhërave për lirinë masivisht të të miturve
- ✓ Dekriminalizimin e menjëhershëm të imigracionit të parregullt dhe shkeljeve të tjera administrative që lidhen me të
- ✓ Zgjerimin e qasjes në rrugë të sigurta e të rregullta migracioni si dhe dhënien e mundësive për rregullimin e statusit të migrantëve në situatë migracioni të parregullt.

Gjatë procesit të lirit, Qeveritë duhet të ndjekin rekomandimet e Udhëzuesit të OBSH-së për COVID-19 në Burgje si dhe Udhëzuesit të Ndërmjetëm të KPNA-së, për të bërë të mundur sipas nevojës parandalimin e infektimit, mospërhapjen, mbajtjen nën kontroll dhe trajtimin e virusit.

3.2 Parandalimi i Prurjeve të Reja të Fëmijëve në Mjediset e Privimit të Lirisë

Shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të parandaluar hyrjet e reja të fëmijëve në vende të privimit të lirisë. Shtetet duhet të vendosin një moratorium të menjëhershëm për të gjitha arrestimet, grumbullimin e fëmijëve në situatë rruge, mbajtjen gjatë natës ose pranimit e reja të fëmijëve në institucionet e privimit të lirisë. Megjithatë, atëherë kur një autoritet kompetent gjykon, mbështetur mbi interesin më të lartë të të miturit, se pranimi i një situatë të privimit të lirisë është i ligjshëm, i nevojshëm dhe proporcional në rrethanat individuale, Shtetet duhet:

- T'i ekzaminonjë të gjithë fëmijët (si dhe kujdestarët e tyre kur janë të privuar nga liria së bashku) dhe të ndërmarrin të gjitha hapat në përputhje me protokollet e shëndetit publik që ka nxjerrë Organizata Botërore e Shëndetësisë;
- Atëherë kur është i nevojshëm distancimi social, izolimi apo karantinimi i një fëmije për arsye shëndetësore, këto masa duhet të merren në kushtet e shtëpisë apo pranë një institucioni të kujdesit shëndetësor dhe jo në mjediset e burgut a paraburgimit.

3.3 Mbrojtja e Shëndetit dhe Mirëqenies së të Miturve të Burgosur

Shtetet duhet të mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien e atyre fëmijëve që mbeten të privuar nga liria. Fëmijëve që nuk mund të lirohen menjëherë dhe që vijojnë të privohen nga liria edhe gjatë pandemisë, iu duhet ofruar mundësia të marrin shërbimet e nevojshme për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e tyre, pa diskriminim, përfshi edhe ato shërbime shëndetësore që duhen për të adresuar nevojat që ata mund të kenë lidhur me COVID19. Autoritetet duhet:

- T'i mbajnë fëmijët nën mbikqyrje për ndonjë nga simptomat e sëmundjes dhe të ndërmarrin hapat e nevojshme për mospërhapjen dhe trajtimin për cilindo fëmijë që shfaq simptomat që përshkruajnë udhëzuesit e OBSH-së për mbikqyrjen shëndetësore, mospërhapjen dhe trajtimin;
- Çfarëdo vendimi për ta vendosur fëmijën në izolim mjekësor, ta marrin vetëm në bazë të domosdoshmërisë mjekësore për një masë të tillë dhe si rezultat të një vendimi klinik e të autorizuar me ligj apo rregullore;
- Ta informojnë fëmijën e vendosur në izolim për shkaqe shëndetësore për arsyen se pse është izoluar. ^{xvii} Nëse distancimi social dhe izolimi konsiderohen të nevojshëm për të mbrojtur shëndetin e fëmijës apo të të tjerëve, atëherë duhet përdorur karantinimi në shtëpi ose në një institucion shëndetësor, në përputhje me udhëzuesit e OBSH-së.
- Kurrësi të mos e vënë fëmijën vetëm, në izolim për asnjë arsye, pasi kjo është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, qoftë edhe për shkaqe shëndetësore; izolimi për shkaqe shëndetësore nuk duhet të përdoret *de facto* si masë izolimi apo ndëshkimi;
- T'i ofrojnë fëmijës shërbimet e përshtatshme shëndetësore, të ushqyerjes, arsimore dhe ligjore, si dhe shërbimet që i përgjigjen dhunës (përfshi dhunën me bazë gjinore), si dhe

shërbime të tjera që përshtaten për nevojat që lindin nga distancimi social dhe nga masat e tjera për mospërhapjen e sëmundjes;

- T'i ofrojnë të miturit ujë, mjete dhe shërbime për pastrim dhe higjienë, veçanërisht ujë e sapun, dhe të ofrojnë mjediset, pajisjet me mjetet e nevojshme për pastrim, për të parandaluar dhe penguar përhapjen e infeksionit;
- T'u ofrojnë fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre [Shërbime Psiko-Sociale dhe të Shëndetit Mendor](#) (ShPSShM), përfshi edhe atyre që kanë patur që më përpara probleme psiko-sociale apo të shëndetit mendor, por edhe atyre që përjetojnë stres dhe frikë lidhur me COVID-19. Këto shërbime duhet t'i përshtaten secilit individ, të jenë të ndjeshme nga pikëpamja gjinore dhe në përputhje me moshën;
- Të vënë në zbatim procedura për t'u lejuar fëmijëve të privuar nga liria të mbajnë kontakt dhe akses të rregullt me dhe ndaj kujdestarëve dhe familjeve të tyre, duke përfshirë masat e mëposhtme:
 - Të udhëzojnë personelin e institucioneve për të mitur që të rritin numrin dhe t'u ofrojnë informime të rregullta familjeve (duke përfshirë edhe përmes telefonit apo kompjuterit) lidhur me vendndodhjen, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës, si dhe fëmijëve lidhur me familjet e tyre;
 - Të mbështetin fëmijët me rrugë të ndryshme, në përputhje me Udhëzuesin e OBSH-së për COVID-19 në Burgje,^{xviii} që të mbajnë lidhjet shoqërore, duke përfshirë këtu edhe vizita personale nga anëtarët e familjes, për shembull duke zgjatur fashën orare kur mund të lejohen vizitat, duke i shpërndarë vizitat jo në oraret e zakonshme (jo të gjitha njëherësh), me qëllim që të maksimizohet distancimi fizik, ose duke përdorur teknologjinë për të lehtësuar komunikimin;
 - Të heqin tarifat ose kostot që mund të lidhen me burimet celulare apo digjitale që iu duhen familjeve, për të lehtësuar kështu komunikimin mes fëmijëve dhe familjeve të tyre;
 - Të marrin në konsideratë që të bëjnë përjashtime të posaçme për udhëtimin e prindërve dhe familjeve, me qëllim që t'u krijojnë atyre mundësinë t'u bëjnë vizita të miturve.
- Të mbajnë nën mbikqyrje dhe përshtatin numrin e personelit dhe ofruesve të shërbimeve në institucionet ku të miturit privohen nga liria, me qëllim që të sigurojnë numrin e mjaftueshëm të personelit për t'u kujdesur dhe mbrojtur fëmijët, si dhe për të mos bërë që fëmijët të detyrohen të mbajnë mbi supet e veta përgjegjësi të tepruar lidhur me mbajtjen e rregullit dhe pastërtisë në mjedise, në rast se personeli dhe ofruesit e shërbimeve janë ekspozuar, infektuar apo janë semurur nga virusi, ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund t'i vijoje dot detyrat e veta.

Shtetet duhet të udhëhiqen nga Udhëzuesi i OBSH-së për COVID-19 në Burgje lidhur me masat mbrojtëse dhe mbështetëse për personelin e mjediseve të burgimit/paraburgimit (p.sh.: ShPSShM, përfshi orientime se si të kujdesen për veten, mbështetje për kujdesin ndaj personelit si dhe shërbime për mirëqenien dhe shëndetin mendor të vetë atyre).^{xix}

3.4 Mbrojtja e Fëmijëve nga Dhuna, Abuzimi dhe Shfrytëzimi

Shtetet duhet të garantojnë të drejtat e fëmijëve dhe t'i mbrojnë ata nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi. Autoritetet duhet të ndërmarrin hapa për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve të privuar nga liria dhe të ulin cenueshmërinë e tyre nga dhuna, abuzimi, lënia pas dore dhe shfrytëzimi, të cilat mund të theksohen edhe më tepër nga sëmundja apo nga masat kufizuese, ose të cilat mund të vijnë si një pasojë dytësore. Kështu, autoritetet duhet:

- Të hartojnë një plan gjithëpërfshirës dhe të detajuar që përshkon të gjitha organet shtetërore, për të siguruar zbatimin dhe përgjigjen e kontrolluar ndaj pandemisë së COVID-19 lidhur me fëmijët në burgim/paraburgim, duke përfshirë këtu përcaktimin e shërbimeve të drejtësisë për të mitur dhe atyre sociale si sektorë të domosdoshëm, të cilët duhet të vijojnë të ofrojnë shërbimet e tyre. Bashkëpunimi duhet të përfshijë ministrinë e drejtësisë, sigurisë, të brendshme, të imigracionit, të financës, të shëndetësisë, të mbrojtjes sociale, të arsimit dhe çfarëdo institucioni tjetër që ka autoritet mbi masat sociale dhe shëndetësore (duke përfshirë kujdesin psiko-social dhe atë për shëndetin mendor), mbi burimet, mbi ndihmën ligjore dhe të tjera, si dhe mbi kontaktet me familjet dhe komunitetet;
- Të përfshijnë fëmijët në procesin e hartimit të këtij plani, duke u dhënë atyre mundësinë të shprehin mendimet e veta dhe të marrin pjesë në vendimet që i prekin ata;
- Të vënë në funksionim dhe në zbatim politika, procedura dhe mekanizma ankimi me synim mbrojtjen, përfshi këtu parandalimin e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit;
- Të lejojnë kontaktin dhe qasjen e vazhdueshme dhe të rregullt mes fëmijëve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë,^{xx} për shembull duke e zgjatur fashën kohore kur mund të zhvillohen vizitat ose lejimin e vizitave përtej orareve të zakonshme (jo të gjitha njëherësh), me qëllim që të maksimizohet distancimi fizik, ose duke përdorur teknologjinë për të lehtësuar komunikimin, ndërsa bëjnë kujdes gjithsesi që të mbrojnë fshehtësinë e këtyre ndërveprimeve; përdorimi i burimeve celulare apo digjitale për lehtësimin e këtyre komunikimeve duhet të jetë falas;
- Të respektojnë garancitë procedurale dhe ato për një proces të rregullt ligjor, duke lejuar gjithashtu zhvillimin e seancave gjyqësore apo administrative që kanë të bëjnë me fëmijët, vijimin e lirimeve apo lëshimin e fëmijëve për shkak të kalimit të afateve të periudhës së paraburgimit,^{xxi} edhe pse është situata e urgjencës së COVID-19 (për shembull duke gjetur zgjidhje teknologjike, ose duke krijuar orare fleksibël për zhvillimin e seancave gjyqësore urgjente);^{xxii}
- Të lejojnë inspektimin e të gjitha mjediseve ku fëmijët privohen nga liria, nga institucione të pavarura kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut,^{xxiii} nga autoritetet shëndetësore dhe ato të mbrojtjes së fëmijëve, madje edhe në institucione dhe mjedise ku infeksioni mund të jetë i pranishëm, dhe madje edhe aty ku individët mund të mbahen të izoluar për shkaqe shëndetësore.

4. Burime

<i>Udhëzuesi i Ndërmjetëm i Komitetit të Përherëshëm Ndër-Agjenci lidhur me COVID-19: Me në Qendër Personat e Privuar nga Liria</i>	Udhëzues operacional lidhur me personat e privuar nga liria dhe COVID-19
<i>Udhëzuesi i Ndërmjetëm i OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë</i>	Udhëzuesi i OBSH-së për COVID-19 në Burgje
<i>OHCHR (Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut) COVID-19 dhe dimensionet e të drejtave të njeriut që lidhen me të</i>	OHCHR Udhëzues për Covid-19
<i>Nënkomiteti i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimeve e Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese</i>	Këshilla nga Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës drejtuar Shteteve Palë dhe Mekanizmave Kombëtare të Parandalimit të Torturës lidhur me Pandeminë e Koronavirusit (Version i avancuar i paedituar, miratuar më 25 mars 2020)
<i>Penal Reform International (Reforma Penale Ndërkombëtare) Përmbledhje lidhur me Koronavirusin</i>	Shënime përmbledhëse që përmbajnë rreziqet dhe praktikatat që vijnë nga vende të ndryshme
<i>ILF Pandemia e Koronavirusit: Udhëzime nga Ofruesit e Ndhmës Ligjore për Mbrojtjen e Shëndetit dhe të Drejtave të Njeriut të të Burgosurve</i>	Veprime që ofruesit e ndihmës ligjore mund të ndërmarrin për të adresuar pandeminë e COVID-19 dhe për të kufizuar shkallën e ndikimit të saj te personat e privuar nga liria
<i>TDH Përshpejtoni lirimimin e fëmijëve nga burgimi</i>	Deklaratë që përmban udhëzime lidhur me lirimimin e fëmijëve si pasojë e COVID-19
<i>Fusha e Mbrojtjes së Fëmijëve – Menu burimore për COVID-19</i>	Një listë burimesh për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me përgjigjen ndaj COVID-19
<i>Aleanca për Mbrojtjen e Fëmijëve në Veprimtarinë Humanitare – burime për COVID-19</i>	Një listë burimesh mbi COVID-19
<i>Mesazhe dhe Veprime kyçe për sëmundjen e koronavirusit (COVID-19) lidhur me parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll nëpër shkolla</i>	Udhëzues operacional për mbrojtjen e fëmijëve dhe shkollave nga COVID-19
<i>INEE Faqja e burimeve mbi Koronavirusin e Ri (COVID-19)</i>	Një listë burimesh për COVID-19 lidhur me arsimin në situata urgjence
<i>KPNA Shënime përmbledhëse të Grupit të Referencës për ShPSShM – Aspekte që lidhen me COVID-19</i>	Shënime përmbledhëse për aspekte të ShPSShM në kuadrin e shpërthimit të koronavirusit të ri (COVID-19)
<i>Integrimi i veprimeve që kanë të bëjnë me përgjigjen ndaj dhunës me bazë gjinore dhe minimizimin e dëmeve të saj.</i>	Një listë me burime lidhur me zvogëlimin e rreziqeve nga DhBGj gjendet këtu .

5. Shënime fundore

ⁱ Në këto shënime, termi të mitur “të privuar nga liria” përfshin fëmijët që janë në “çfarëdo forme paraburgimi a burgimi ose të vendosur ... në një mjedis publik a privat ndalimi, nga ku [ata] nuk lejohet të largohen sipas dëshirës, bazuar mbi një urdhër të lëshuar nga ndonjë autoritet gjyqësor, administrativ ose tjetër”, sipas Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (Rregullat e Havanës), neni 11 (b) dhe sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, neni 37.

ⁱⁱ “[F]ëmijët nuk duhet të privohen kurrësi nga liria për shkaqe që lidhen me statusin si migrant të prindërve të tyre dhe Shtetet duhet të ndalojnë tërësisht dhe të çrënjoshin pa vonesë burgimin e fëmijëve për shkaqe imigracioni. Çfarëdo forme burgimi për fëmijët në kuadrin e imigracionit duhet të ndalohet me ligj dhe ky ndalim duhet të zbatohet plotësisht në praktikë.” Koment i Përgjithshëm i Përbashkët Nr. 4 (2017) i Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punonjësve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre dhe Nr. 23 (2017) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës lidhur me detyrimet e Shteteve për të drejtat e njeriut të fëmijëve në kontekstin e migrimit ndërkombëtar, në vendet e origjinës, tranzitit, destinacionit dhe kthimit, paragrafi 5. Shih gjithashtu [Kompaktin Global për Migrimin e Sigurt dhe të Rregullt](#); [Pozicioni i UNHCR-së lidhur me burgimin e fëmijëve refugjatë dhe migrantë](#) në kontekstin e migracionit; UNICEF, [Alternativa ndaj Burgimit të Fëmijëve për Shkaqe Imigrimi](#) (shkurt 2019); dhe UNHCR, [Konsiderata Ligjore Kyçe për hyrjen në territor të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në kontekstin e përgjigjes ndaj COVID-19](#) (16 mars 2020)

ⁱⁱⁱ Ky dokument përqendrohet te fëmijët e privuar nga liria në sistemet e drejtësisë penale, për shkaqe që lidhen me sigurinë kombëtare, përfshi edhe sistemet ushtarake të drejtësisë dhe burgimin për shkaqe imigracioni. Çështje që kanë të bëjnë me COVID-19 dhe fëmijët në institucione të përkujdesit rezidencial, do të adresohen përmes një udhëzuesi të veçantë por që do të përforcojnë njëri-tjetrin (është duke u përgatitur).

^{iv} Udhëzuesi i Ndërmjetëm i OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë (mars 2020), fq.1; Shih edhe [Udhëzuesin e Ndërmjetëm të Komitetit të Përhershëm Ndër-Agjenci lidhur me COVID-19: Me në Qendër Personat e Privuar nga Liria](#) (mars 2020); dhe Studimin Global të Kombeve të Bashkuara mbi të Miturit e Privuar nga Liria, Manfred Nowak (2019), kapitulli 6: Ndikimet në shëndetin e të miturve të privuar nga liria.

^v Shih edhe Udhëzuesin e Ndërmjetëm të OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë (mars 2020) “Përpjekjet e botës për të penguar përhapjen e sëmundjes mund të dështojnë nëse nuk iu jepet vëmendja e duhur masave për ta mbajtur sëmundjen nën kontroll brenda në burgje.” Shih gjithashtu Kryqi dhe Gjysmëhëna e Kuqe Ndërkombëtare, [COVID-19: Mbrojtja e popullatave të burgjeve nga infeksioni i sëmundjes së koronavirusit](#) (11 mars 2020)

^{vi} Shih për shembull nga CRIN, [Koronavirusi dhe fëmijët në burgje](#) (26 mars 2020); shih edhe nga Reforma Penale Ndërkombëtare, [Shënime përmbledhëse Koronavirusi: Kujdesi shëndetësor dhe të drejtat e njeriut të personave në burgje](#) (16 mars 2020)

^{vii} Shih përgjithësisht Udhëzuesin e Ndërmjetëm të OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë (mars 2020), Udhëzuesin e Ndërmjetëm të Komitetit të Përhershëm Ndër-Agjenci lidhur me COVID-19: Me në Qendër Personat e Privuar nga Liria (mars 2020); Human Rights Watch, [ShBA: COVID-19 Kërcënon njerëzit Prapa Hekurave](#) (12 mars 2020) dhe [Dimensionet e të Drejtave të Njeriut në Përgjigjen ndaj COVID-19](#) (19 mars 2020), fq. 8-10.

^{viii} Miniumi e drejta e jetës, e drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor a poshtërues, e drejta për të mos qenë i skllavëruar apo për të bërë punë të detyruar, si dhe e drejta për t’u mbrojtur nga fuqia paravepruese e ligjit penal, mbrojtja nga heqja arbitrare e lirisë, nga përzënia kolektive apo nga kthimi në kufi.

^{ix} Shih përgjithësisht Komitetin për të Drejtat e Fëmijës, Komentin e Përgjithshëm Nr. 24 (2019) për të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të mitur, CRC/C/GC/24 (18 shtator 2019); Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Standardet Minimum të Administrimit të Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit) GA 40/33 (29 nëntor 1985); Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Miturve (Udhëzuesit e Riadit) GA 45/112 (14 dhjetor 1990); Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (Rregullat e Havanës) GA 45/113 (14 dhjetor 1990); Udhëzime për Veprimet me të Miturit në Sistemin e Drejtësisë Penale (Udhëzimet e Vienës) Rezolutë e Këshillit Ekonomik dhe Social 1997/30 (21 korrik 1997); Udhëzime për Çështjet e Drejtësisë që përfshijnë Fëmijët Viktima a Dëshmitarë të Krimeve, Rezolutë e Këshillit Ekonomik dhe Social 2005/20 (22 korrik 2005); Strategjitë Model të Kombeve të Bashkuara dhe Masat Praktike për Eliminimin e Dhunës ndaj Fëmijëve në Fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale (Strategjitë Model të KB për DhF) GA 69/194 (18 dhjetor 2014).

^x Duke përfshirë Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (AP 45/113, dt. 14 dhjetor 1990); Rregullat Standarde Minimum të Kombeve të Bashkuara për Masat jo me Burgim (AP 45/110, dt. 14 dhjetor 1990); Parimet Bazë të Trajtimit të të Burgosurve (AP 45/111, dt. 14 dhjetor 1990).

^{xi} Këtu përfshihet edhe informacioni i arritshëm dhe miqësor për fëmijët lidhur me shpërthimin e COVID-19, simptomat e sëmundjes, si mund të mbrohen fëmijët prej saj, mundësitë e trajtimit dhe informacion tjetër me karakter shëndetësor.

- ^{xii} Veçanërisht [Standardi 20: Drejtësia për të Mitur](#), dhe [Standardi 11: Fëmijët e lidhur me forcat e armatosura apo grupe të armatosura](#)
- ^{xiii} Fëmijët që jetojnë me një person kryesor që kujdeset për ta – zakonisht nëna, por ka raste kur është edhe babai ose dikush tjetër që është i vetmi person që kujdeset për fëmijën – kur ky ose kjo është i/e burgosur apo në kushtet e privimit të lirisë. Shih në përgjithësi, [Studimin Global të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët e Privuar nga Liria](#), Manfred Nowak (2019), kapitulli 10: Fëmijët që jetojnë në burgje me kujdestarin e tyre kryesor.
- ^{xiv} Këtu përfshihen fëmijët (të pashoqëruar, të ndarë ose së bashku me familjet e tyre) dhe familjet në vendet ku izoloohen para se të largohen, kur riatdhesimet janë pezulluar për shkak të situatës së COVID-19. Shih për shembull Këshillin e Evropës, [Deklarata nga Komisioneri bën thirrje që të burgosurit për shkaqe imigracioni të lirohen gjatë vazhdimit të krizës së COVID-19](#) (26 mars 2020)
- ^{xv} Fëmijët që janë burgosur për shkak të lidhjes së tyre, të vërtetë ose të supozuar, me forcat e armatosura apo grupet e armatosura, përfshi ato grupe të cilësuar si terroriste, janë viktime të një prej gjashtë shkeljeve më të rënda të të drejtave të fëmijëve në situata të konflikteve të armatosura dhe ndaj, duhet të trajtohen si të tilla. (Protokollet Shtesë të Konventave të Gjenevës, n. 77(2) PSh I; n. 4(3) PSh II; shih edhe Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 2427 (2018)).
- ^{xvi} Kjo përfshin edhe fëmijët në burgim për shkaqe imigracioni, ku përparësia kryesore është lirimi i tyre i menjëhershëm nga institucionet ku mbahen.
- ^{xvii} Shih për shembull nga Shoqata Kombëtare e Psikologëve Shkollorë dhe nga Shoqata Kombëtare e Infermierëve Shkollorë, [T'u flasësh fëmijëve rreth COVID-19 \(Koronavirusit\): Një burim për prindërit](#)
- ^{xviii} [Udhëzuesi i Ndërmjetëm i OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë](#) (mars 2020), fq.8, 15 dhe 21-22; Shih edhe [Udhëzuesin e Ndërmjetëm të Komitetit të Përhershëm Ndër-Agjenci lidhur me COVID-19: Me në Qendër Personat e Privuar nga Liria](#) (mars 2020)
- ^{xix} Udhëzuesi i Ndërmjetëm i OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë (mars 2020); dhe Komiteti i Përhershëm Ndër-Agjenci, Shënime përmbledhëse të Grupit të Referencës për Shëndetin Mendor dhe Mbështetjen Psiko-Sociale në Situata të Urgjencës, [Shënime përmbledhëse për adresimin e aspekteve psiko-sociale dhe ato të shëndetit mendor gjatë shpërthimit të COVID-19 Version 1.1](#) (shkurt 2020)
- ^{xx} Fëmijët refugjatë ose azil-kërkues, përfshi edhe rastet kur privohen nga liria, kanë të drejtë të mbajnë kontakt me UNHCR, shih Udhëzuesit e UNHCR-së për Burgimin 2012 dhe Konkluzionin e Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së, Nr. 85 (XLIX), 1998.
- ^{xxi} Në rastin e fëmijëve, paraburgimi nuk duhet përdorur përveçse si një masë e fundit fare, në rastet më të rënda, dhe vetëm pasi lirimi, vendosja në nivel komunitar ose programet e shmangies të jenë marrë seriozisht në konsideratë, shih Komitetin për të Drejtat e Fëmijës, Komentin e Përgjithshëm Nr. 24 (2019) lidhur me të drejtat e fëmijës në sistemet e drejtësisë (2019) CRC/C/GC/24, para 86.
- ^{xxii} Shih për shembull Fondacionin Juridik Ndërkombëtar, [Pandemia e Koronavirusit: Udhëzues për Ofruesit e Ndihmës Ligjore për Mbrojtjen e Shëndetit dhe të Drejtave të Njeriut të të Burgosurve](#) (mars 2020)
- ^{xxiii} Udhëzuesi i Ndërmjetëm i OBSH-së për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të COVID-19 në burgje dhe vende të privimit të lirisë (mars 2020), fq. 5; Udhëzuesi i Ndërmjetëm i Komitetit të Përhershëm Ndër-Agjenci lidhur me COVID-19: Me në Qendër Personat e Privuar nga Liria (mars 2020); dhe Nënkomiteti i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimeve e Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese, Këshilla nga Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës drejtuar Shteteve Palë dhe Mekanizmave Kombëtare të Parandalimit të Torturës lidhur me Pandeminë e Koronavirusit (Version i avancuar i paedituar) (miratuar më 25 mars 2020).

Miratuar nga:

